

REPUBLIKA E SHQIPERISE

“ SINA 98” Shpk

Adresa: Fshati Shkoze Ish U. Traktori

Cel:0682024774, fax++359514

Nr. ____ Prot.

Tirane, me ____/____ 2014

Lenda: Informimi dhe pjesmarrja e publikut mbi aplikimin te subjektit “Sina 98” shpk

Drejtuar: Agjensise Kombetare te Mjedisit Tirane

Ne zbatim te VKM nr.419 date 25.06. 2014 kreu VI i ketij vendimi ,per informimin dhe pjesmarrjen e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B, subjekti “ **Sina 98** “ sh.p.k paraqet nje kerkese per Leje Mjedisi Tipit B duke iu permbajtur kerkesave te ketij kreu si me poshte:

A.Informacion ne lidhje me aplikimin per leje mjedisi

Subjekti “**Sina 98** “ shpk aplikon kete kerkese per leje mjedisi te tipit B ne **impjantin dhe instalimin ekzistues** me vend ndodhje ne Qafe –Priske te fshatit Priske te komunes Dajt **pas nje nderprerje te aktivitetit** qe nga viti 2010.

Shoqeria “**Sina 98**” shpk ka qene e paisur nga dy ministrite perkates , nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave si dhe nga Ministria Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes , me leje mjedisi dhe me leje minerare per nje periudhe 10 vjecare (2000- 2010) .

B. Te dhenat mbi ekstraktin e subjektit “Sina 98” shpk

Subjekti “ **Sina 98**” shpk eshte themeluar me 08.01 1998 dhe e regjistruar ne QKR me dt. 08.01 2000 me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e paisur me nr. Identifikim **NIPT K01321001T**.Kjo shoqeri eshte krijuar me pjesmarrje te kapitalit prej 50% te ortakeve Aqif e Shaban Sina dhe me perfaqesues ligjor te shoqerise z.**Shaban Sina** .

C. Adresa e vend ndodhjes se instalimit

Kjo shoqeri me **seli ne fshatin Shkoze ish Uzina e Autotraktoreve Tirane** ushtron aktivitetin e saj qe nga viti 2000 ne prodhimin e materialeve te ndertimit me **adrese : Nomenklatura K-34-100-B-b,Qafe-Priske fshati Priske, komuna Dajtit rrethi Tirane qarku Tirane**

C.Permbledhje Jo teknike e raportiti te vleresimit te ndikimit ne mjedis (Aneksi 14)

ANEKSI 14

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

1-INSTALIMI DHE AKTIVITETI

a.Aktiviteti I shoqërisë “SINA 98” shpk për shfrytëzimin dhe prodhimin e inerteve

Kantieri për prodhimin e inerteve të shoqërisë “SINA 98” shpk është i vendosur në Qafë– Priskë. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror, me NR NIPT: K01321001T. Në këtë kantier prodhohet çakull 8-12 mm dhe 12-20 mm, granil 4-8 mm dhe me shumë dimensione, rërë dhe granil standart shqiptar S SH EN 12620 : 2004. Gjithashtu ky kantier prodhon stabilizant për shtrime rrugësh apo përdorime të tjera si dhe çakull sipas porosisë së klientit.

Kapaciteti i impiantit të inerteve shkon deri në 100 m³/orë. Për prodhimin e inerteve sipas standarteve shoqëria “SINA 98” ka hartuar një Deklaratë Konformiteti dhe garanton të gjitha cilësitë e kërkuara. Ky kantier punon për të plotësuar nevojat e firmës dhe për të tretë. Impiantet janë të automatizuara dhe miqësore me mjedisin sepse “SINA 98” mendon për mbrojtjen dhe ruajtjen e parametrave mjedisorë, i cili është prioritet thelbësor i kësaj shoqërie, me qëllim shfrytëzimin e mineralit gëlqeror duke menduar edhe për gjeneratat e brezave pas ardhës.

Objekti i gëlqerorëve të marrë për shfrytëzim nga Shoqëria “SINA 98” sh.p.k. meseli në qytetin e Tiranës, ndodhet në të djathtë të rrugës Nacionale Qaf Priskë – fshati Murth ngjitur me këtë rrugë.

Ky objekt ndodhet në Jug – Perëndim të fshatit Shkallë në një distancë rreth 1 km larg në vijë ajrore, ndërsa fshati Murth ndodhet në Jug Lindje të zonës në fjalë në një distancë në vijë ajrore rreth 1.3 km. Qyteti i Tiranës ndodhet rreth 25 km nga zona ku kërkohet të bëhet shfrytëzimi i gurit gëlqeror dhe nuk duket nga ky qytet pasi është prapa malit të Priskës.

Objekti është i lidhur me rruge makine të kategorise së tretë e pa asfaltuar, por në gjendje të mirë që lidh fshatin Murth me rrugën nacionale Tiranë – Qaf Mollë. Zona e kërkuar bën pjesë në hartën topografike në shkallë 1 : 25000 me moniklaturë K- 34 – 100-B-b (Priska).

b. Titulli instalimit I subjektit është “**Industri minerare**” kjo sipas kollones 1 te Shtojces 1 te ligjit Nr. 10448 dt 14.07.2011 “Per leje Mjedisit” I ndyshuar , ndersa pershkrimi I veprimtarise dhe kapaciteti prodhues eshte **ID 3.7 “Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret “** sipas Shtojces 1 te ligjit nr.10448 dt 14.7.2011 Subjekti **Sina 98” shpk ushtron aktivitetin** e tij ne shfrytezimin e gurit gelqerore dhe ne prodhimin e inerteve te gurit si rere, granil dhe cakell sipas sdantarteve te kerkuara per nevojat e subjekteve te ndertimit ne tregun e brendeshem. Gjithashtu ky subject prodhon stabilizant per shtrime rruges etj.

c. Pershkrimi I projektit (Vendndodhja)

Vendndodhja e rajonit të objektit të gëlqerorëve .

Objekti i gëlqerorëve të marrë për shfrytëzim nga Shoqëria “Sina 98” sh.p.k. meseli në qytetin e Tiranës, ndodhet në të djathtë të rrugës Nacionale Qaf Priskë – fshati Murth ngjitur me këtë rrugë.

Ky objekt ndodhet në Jug – Perëndim të fshatit Shkallë në një distancë rreth 1 km larg në vijë ajrore, ndërsa fshati Murth ndodhet në Jug – Lindje të zonës në fjalë në një distancë në vijë ajrore rreth 1.3 km.

Qyteti i Tiranës ndodhet rreth 25 km nga zona ku kërkohet të bëhet shfrytëzimi i gurit gëlqeror dhe nuk duket nga ky qytet pasi është mbrapa malit të Priskës.

Objekti është i lidhur me rrugë makine të kategorise së tretë e pa asfaltuar, por nëgjendje të mire që lidh fshatin Murth me rrugën

2.REGJIMI I PUNES PER KRYERJEN E OPERACIONEVE.

Regjimi i punës, ndërsa në ditë, ditë në muaj, ose vit, Grafiku i punimeve të zbulimit dhe grafiku i podhimit për gjithë karrierën.

a.Kapaciteti Prodhues

Prodhimi realizuar nga shfrytëzimi i këtij vendburimi në zonën e kërkuar do të ketë si destinacion përdorimin e tij në industrinë e ndërtimit të rajonit në formë të gurëve të prodhuar direkt nga karriera dhe të materialit të përpunuar si rërë, granil apo çakull si dhe prodhimin e gëlqerës apo të industrisë së çimentos. Për këtë arsye, në varësi të tregut të studiuar dhe të pritshëm, subjekti parashikon një prodhim vjetor prej rreth 100 000 m³/vit.

b.Regjimi i punës

Për realizimin e prodhimit të parshikuar karriera do të punojë **12 muaj, 22 ditë në muaj** me një ndërsë **në ditë dhe me 7 orë /ditë.**

Për vitin e parë të aktivitetit të saj karriera do të punojë me një intensitet më të lartë për realizimin e zbulimit, kryerjen e rrugës së hapjes në pjesën e poshtëme, sistemimet e ndryshme dhe të prodhimit.

c.Grafiku i zbulimit dhe prodhimit

Sasia e përgjithëshme e zbulimit të kësaj karriere është 21642 m³ dhe parashikohet të realizohet duke filluar që në vitin e parë dhe duke vazhduar progresivisht në vitet e tjera në vazhdim .

Zbulimi tërsor i karrierës parashikohet të përfundojë në vitin e shtatë

Në 10 vitete e para të karrierës parashikohet të kryhet zbulimi i plotë të karrierës deri në shkallën +580m.

3.LENDA E PARE NDIHMESE SI DHE ENERGJIA E PERDORUR NE INSTALIM

a.Lendet e para

Transportimi i lëndëve të para, të cilat luajnë një rol kyç për operimin normal dhe brenda normave të sigurimit teknik, të proceseve që realizohen në karrierën e gurit gëlqeror. Transporti sigurohet nga mjetet e shoqërisë “SINA 98”, mjetet janë të pajisura me kadin e lëndës që transportojnë. Furnizimi me lëndë të pare bëhet periodikisht sipas kërkesave dhe operacioneve që realizohen në objektin e karrierës. Mjetet e transportit janë të kolauduara dhe të mbuluara, me qëllim shmangien e rrezikut për humbje të lëndës së pare gjatë transportit dhe mbrojtjen e mjedisit. Shpejtësia e lëvizjes së mjeteve është brenda rregulloreve dhe kriterëve të transportit të materialeve, në varësi të materialit që transporton.

b.Dorëzimi i lëndëve të para

Mjetet e transportit regjistrohen para hyrjes në territorin e objektit të karrierës. Bëhet verifikimi i materialit që transportohet brenda tyre, nga ekonomisti i shoqërisë “SINA 98” nëse ka mospërputhje të lëndëve që janë porositur dhe lëndëve që kanë ardhur në objekt.

Mjetet e transportit parkohen brenda objektit në vendin e caktuar prej shoqërisë, duke ruajtur të gjitha distancat dhe masat e sigurisë, për operimin norma të punës për shkarkimin e ngarkesës.

Shkarkimi i lëndëve të para realizohet me krah, nën kujdesin e vecantë të drejtuesit teknik dhe masa të mëdha sigurie në varësi të lëndës së pare. Mbas shkarkimit të materialit, bëhet edhe një here verifikimi i tyre, nëse kemi humbje apo dëmtim të lëndës së pare. Drejtuesi teknik sigurohet që ambienti i magazines është i sigurtë, për ruajtjen dhe jetëgjatësinë e lëndëve të magazinuara.

c. Magazina

Magazina do të shërbejë për magazinimin e lëndëve të para, pajisjeve/aparaturave ndihmëse dhe pjesëve të këmbimit për automjetet. Struktura arkitektonike e magazines i plotësojnë të gjitha kushtet tekniko-inxhinierike për magazinimin e sigurtë të lëndëve të para me hapësira të bollshme dhe ndricimin e duhur, sipas normave të sigurimit teknik, në varësi të lëndës së pare magazinohet.

d. Transporti i lendeve te para

Transporti i brendshëm i lëndëve të para realizohet nga punonjësit, të cilët janë të veshur me pajisjet e posacme për lloj e materialit që transportojnë. Në varësi të distances së transportit nga magazina në shkallët e karrierës, përdoren e mjetete të mekanizuara që drejtohen nga punonjësit e firmës, nën kujdesin e drejtuesit teknik, i cili monitoron dhe drejton funksionimin e operacioneve dhe proceseve për shfrytëzimin sa më eficient të gurit gëlqeror.

e. Lendet dihmese

Per realizimin e rrezimit te gipsit (gurit gelqerore) eshte e domosdoshme perdorimi I lendeve ndihmese sic jane dinamiti kapsollat dhe fitili si dhe mase argjili per taposjen e lendes plases te dinamitit pas vendosjes ne birat e hapura ne shkemb.

h. Furnizimi me energji elektrike

Gjatë shfrytëzimit të gurit gëlqeror nuk parashikohet të përdoren makineri dhe pajisje të ndryshme të cilat punojnë me energji elektrike. Makinerit janë të gjitha me motor me diegie të brendëshme kryeisht me naftë. Lidhja telefonike e objektit me subjektin do të bëhet me telefona mobile

4. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI

a. Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitimeve në tokë dhe rrethinat.

Aktiviteti parashikon vetëm shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe nuk lëshon në ambient elemente kimike ose të tjera të dëmshëm për mjedisin.

Materiali, që do të depozitohet në vendet e shrytëzimit, është i pastër dheme tregues fizike, petrografike, kimike. Aktualisht nuk ka asnjë veprimtari industriale apo artizanale që të jetë shkak për grumbullime të dëmshme për mjedisin dhe jetën e njerëzve.

b. Ndikimet në përdorimin e tokës dhe të burimeve. Në cilësinë dhe sasinë e tokës dhe të burimeve .

Sipërfaqja që do të nënshtrohet shfrytëzimit nuk është tokë bujqësore. Ushtrimi i aktivitetit në ke të sipërfaqe nuk ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e tokës bujqësore, pasi toka e bukës është shumë larg.

c. Ndikime të tjera klimaterike

Gjatë dhe pas ushtrimit të aktivitetit të shfrytëzimit, nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Pra kryerje e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimaterike të kësaj zone.

d. Humbje e tokës për kullotë Sipërfaqja e përgjithëshme që do të zejë objekti gjatë shfrytëzimit është 0.164 km². Ajo nuk është e kultivueshme dhe nuk përfaqëson ndonjë kullotë. Në përfundim të

shfrytëzimit kjo sipërfaqe do të sistemohet dhe mbillet me qëllim ripërdorimin e saj . E gjithë zona do tëmbulohet me formacionet deluviale të zbulimit duke mundësuar kështu, pas përpunimit, kultivimin e pemëve të ndryshme lokale dhe barishteve.

Si rrjedhim pas shfrytëzimit nuk do të kemi humbje të sipërfaqes për kullote.

e.Humbje e pjerësisë së tokës

Në projekt, pjerësia e skarpave të shkallëve është parashikuar të jetë 72° . Kjo pjerësi është më e madhe se ajo natyrale e terrenit të objektit. Mbas sistemimit përfundimtar dhe mbushjes do të tentohet që ajo të ulet edhe 10° tjetër.

Humbja e pjerësisë së tokës nga shfrytëzimi do të jetë e konsiderueshme.

f.Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta

Sasi e sterileve të zbulimit, përkohësisht do të depozitohet në sipërfaqet e parashikuara në projekt dhe më vonë do të ritransportohen dhe depozitohen në sheshet e shkallëve dhe në sheshin e poshtëm +780m. Ato përfaqësohen nga deluvione të shkruara, që nuk përmbajnë elemente ndotës për ambientin. Këto depozitime janë fertile dhe do të shërbejnë më së miri për rigjenerimin e karrierës

g.Ndotja e tokës nga depozitimi i llumrave

Gjatë shfrytëzimit të objektit nuk parashikohet depozitime llumrash. Ato, qënë sasi shumë të pakta do të krijohen gjatë reshjeve do të depozitohen brenda karrierës dhe do të ripërdoren në prodhimin e tullave.

h.Erozioni gjatë hapjes dhe shfrytëzimit të objektit mineral.

Në projekt është parashikuar një radhë dhe drejtimi i tillë i shfrytëzimit, që në kombinim me masat e tjera suplementare të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin, shembjen dhe vithisjen e shapateve të karrierës dhe sipërfaqes së tokës rreth saj.

i.Trajtimi i ujrave

Teknologjia e shfrytëzimit të objektit nuk parashikon përdorimin e ujit. Ujrat e reshjeve do të dekantohen në gropa brenda zonës së shfrytëzimit. Rrjedhja e mëtejshme e tyre do të bëhet në përputhje me rrjedhjen natyrale të tyre me anë të një kanali në anë të rrugës së hapjes deri në kanal dhe rrugës së poshteme.

5.SASITË E SHKARKIMEVE NE MJEDIS NGA INSTALIMI DHE IDENTIFIKIMI I TYRE.

a.Nivelet e shkarkimeve ne mjedis të ardhura nga instalimi i projektit

Gjatë fazës normale të operimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazrave, lëngjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, duke përfshirë të gjitha llojet e bimëve dhe gjallesave të ndryshme.

Gjatë transportit të gurit gëlqerorë do të punojnë makinat e transportit, por që nuk kanë ndonjë ndikim në mjedis pasi qëndrimi i tyre në objekt nuk do të jetë për një kohë të gjatë. Mjetet e transportit nuk do të krijojnë ndonjë problem në trafikun e mjeteve pasi dhe numri i tyre do të jetë i vogël.

b. Identifikimi i ndikimeve ne mjedisGjatë shfrytëzimit të objektit parashikohet rigjenerimi hap pas hapi i karrierës së gurit gëlqeror dhe kryerja e punimeve suplementare të mbushjes dhe sistemimit.Në

vendet e caktuara në projekt parashikohet depozitimigurit të papërdorshëm dhe përpunimi i tij me tokën vegjetale për të mundësuar mbjelljen bimët e pemët dhe pemëve karakteristike për këtë zonëtë gjelbëruar dhe më shlodhëse për syrin.

parashikohet depozitimigurit të papërdorshëm dhe përpunimi i tij me tokën vegjetale për të mundësuar mbjelljen bimët e pemët dhe pemëve karakteristike për këtë zonëtë gjelbëruar dhe më shlodhëse për syrin.

Niveli i zhurmave të mjeteve të transportit është i atij niveli që nuk influencon fare si përtë punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat përreth tij.

Fenomene të tilla si vibracion, ndricim, nxehtësia janë të papërfillshme në zhvillim të këtij aktiviteti në këtë objekt. Duhet theksuar që vibracioni në këtë aktivitet është i pranishëm por në rastin konkret është i papërfillshëm fare, sepse po e përmendim edhe një herë ngarkesa me lënde eksplozive është shumë e vogël dhe thellësia e tyre është gjithashtu shumë e vogël dhe numri i plasjeve është shumë i vogël.

Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatëditës, meqenëse në objekt do punohet vetëm me një turn

Emetimet në ajër përfaqsohen nga gazrat që dalin nga motorrët e makinave të transportit gjatë transportimit të gurit gëlqeror.

Duke marrë edhe parasysh që qendrat e banuara janë në një distancë relativisht të largët nga zona ku do të ushtrohet aktiviteti i shfrytëzimit dhe ku do të punojnë këto makina punojnë këto makina.

Emetimet e tjera në ajër përfaqësohen vetëm nga gazrat e materialeve me djegje të brendëshme të kompresorit të makinave të ngarkimit dhe të mjeteve të transportit që do të përdoren për shfrytëzim.

c.Përshkrimi i ndikimeve negative në biodiversitete

Në objektin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në sipërfaqen e kërkuar, nuk ka dhe nuk janë parashikuar ndikime individuale apo të grumbulluara në biodiversitet.

Objekti është në brendësi të territorit të vendit dhe nuk ka ndikimendërkufitare.

d. Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografisë lokale, erozionit të tokës etj.

Gjatë dhe pas përfundimit të shfrytëzimit, do të ketë ndryshime të vogla në topografinë lokale.

Në projekt është parashikuar një radhe dhe drejtimi i tillë i shfrytëzimit, që në kombinim me masat e tjera suplementare të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin e shpateve të karrierës.

e.Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitimeve në tokë dhe rrethinat

Aktiviteti parashikon vetëm shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe nuk lëshon në ambient elemente kimike ose të tjera të dëmshëm për mjedisin.

Materiali, që do të depozitohet në vendet e shfrytëzimit, është i pastër dhe me tregues fizikë, petrografike, kimike. Aktualisht nuk ka asnjë veprimtari industriale apo artizanale që të jetë shkak për grumbullime të dëmshme për mjedisin dhe jetën e njerëzve.

f.Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografisë lokale, erozionit të tokës etj.

Gjatë dhe pas përfundimit të shfrytëzimit, do të ketë ndryshime të vogla në topografinë lokale.

Në projekt është parashikuar një radhe dhe drejtimi i tillë i shfrytëzimit, që në kombinim me masat e tjera suplementare të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin e shpateve të karrierës.

g.Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitimeve në tokë dhe rrethinat

Aktiviteti parashikon vetëm shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe nuk lëshon nëambjent elemente kimike ose të tjera të dëmshëm për mjedisin.

Materiali, që do të depozitohet në vendet e shfrytëzimit, është i pastër dheme tregues fizikë, petrografike, kimike. Aktualisht nuk ka asnjë veprimtari industriale apo artizanale që të jetë shkak për grumbullime të dëmshme për mjedisin dhe jetën e njerëzve.

6. MASAT ALTERNATIVE PER ZBUTJEN DHE PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS.

a. Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit. Masat zbutëse të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë punimeve në ajër, si pluhurat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore në territor, faun dhe florë. Por pikësynimi i studimit mbetet rehabilitimi i tokës dhe evitimi në maksimum i erozionit.

Identifikimi i masave për të eliminuar apo zbutur ndikimet negative në mjedis

b. Planifikimi i zonës

Për shmangien dhe parandalimin e erozionit si dhe për ruajtjen e regjimit tërrymës së ujit të parametrave hidrodinamike të saj, në projekt është përcaktuar shfrytëzimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë të zonës në tërësi dhe i meandrave të shfrytëzimit.

Në zonën e shfrytëzimit hap pas hapi dhe në përfundim të aktivitetit, është parashikuar mbushja, sistemimi, përpunimi dhe mbulimi i një sipërfaqeje të konsiderueshme.

Kjo sipërfaqe e përfutur nga trajtimet e mësipërme, do të japë mundësi për rikultivimin e bimëve dhe pemëve të ndryshme, duke krijuar njëherësh kushte për parandalimin e erozionit dhe përmisimin e pamjes së përgjithshme të zonës së shfrytëzuar.

Duhet theksuar se sipërfaqja e caktuar për shfrytëzim për firmën "Sina 98" shpik është shumë e vogël dhe nuk përbën ndonjë ndikim në zonë.

b. Masat teknike

Për parandalimin e erozionit subjekti parashikon në një vit të kryejë punimet e mëposhtme:

Dhënia e pjerrësisë shkallëve të karrierës me pjerrësi 2% në drejtim të zonës së shfrytëzimit.

Mbjellje para se të fillojë shfrytëzimi të të gjitha periferive të tjera me dëllenjë të kuqe dhe me shkozë të bardhë për të izoluar pjesën e fragmentuar nga shfrytëzimi të atyre të paprekura nga projekti duke lënë mundësinë për përhapje të mëtejshme të këtyre specieve vendase në territoret fqinje. Mbjellja do të bëhet duke marrë mendimin e specialistëve të ndërmarrjes Pyjore.

Të dy këto masa do të shërbejnë si barriera për pluhurin që mund të nxitet nga aktiviteti eolik gjatë shfrytëzimit.

Uljen e intensitetit të shfrytëzimit për stinën e verës duke evituar kështu sa të jetë e mundur erozionin dhe pluhurat. Nga ana tjetër për të ulur efektet erodive gjatë periudhave të thata do të përdoret lagia e terreneve nën punë dhe lagia e vendgrumbullimit të materialit të nxjerrë. Kjo do të evitohet edhe ndotjen gjatë transportit.

Për evitim të rrisqeve nga shpërthimet do të punesohen ekspertë me eksperiencë në këtë fushë.

Për rritjen e efektivitetit ekonomik-ekologjik për të gjithë veprimet konkrete do të merren masa mbikqyrës nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor.

Të gjithë masat e tjera për sigurinë në punë, mbrojtjen e sheëndetit etj, janë paraqitur në studimin gjeologo-minerar.

7.PLANI MENAXHIMIT TE MBETJEVE

a.Plani i Menaxhimit të Mbetjeve

Aktiviteti i shfrytëzimit të gurit gëlqeror, nga shoqëria "SINA 98", për objektin **Nomenklatura K-34-100-B-b, Qaf Priskë, Fshati Priskë, Komuna Dajt, rrethi Tiranë, qarku Tiranë**, nga proceset e ndryshme të operimit të punës në karrierë gjenerohet një sasi e konsiderueshme mbetjesh.

Rrymat prioritare të mbetjeve të gjeneruara në karrierë, ndahen sipas fraksioneve të mëposhtme:

- Mbetje të ngurta (Dhera)
- Mbetje të ngurta urbane (Mbetjet të ambalazhit, karton, plastik, kanaçe, etj)
- Mbetje organike (Mbetje të Kompostueshme)

b.Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve: Diferencimi i mbetjeve të gjeneruar Brenda zones së karrierës, sipas fraksioneve kryesore nëpërmjet instalimit të sistemit me 3-Kontenier, transportimi i tyre periodik në vendin e caktuar nga njësia vendore Komuna Dajt, permes bashkëpunimit me NJQV-të (Komuna/Bashki) për firmat e kontraktuara në grumbullimin e mbetjeve urbane, në ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme në diferencimin e mbetjeve, duke maksimizuar dobinë e Landfillit Rajonal Sharrë.

Menaxhimi i mbetjeve brenda zones së instalimit është tësisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Komunës Dajt.

Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:

- Instalimi i sistemit me 3-kontenier brenda zones ku zhvillohet aktiviteti
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare (Plastik, Letër/Karton dhe Mbetje të tjera).
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendepozitimin e caktuar nga Njësia Vendore.
- Nëshkrimi i kontratave me biznesin e riciklimit për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane që gjenerohen nga aktiviteti
- Transportimin e dherave në vendepozitimin e caktuar brenda zones së objektit dhe përdorimi i tyre për qëllime rehabilitimi.

Synimet:

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e objektit dhediferencimin e mbetjeve sipas tre rrymave kryesore.
- Organizimi i diferencuar i mbetjeve në përputhje me politikat kombëtare, për të mundësuar dhe stimuluar metodat e trajtimit të mbetjeve (riciklimi dhe kompostimi).
- Planifikimi dhe ngritja në nivelin zonal i një rrjeti të kontenierëve për diferencimin e mbetjeve me qëllim për të maksimizuar dobinë e Landfillit të Sharrës.
- Maksimizimi i përdorimit të mbetjeve urbane ne shkallen 30% deri ne fund te 2015

- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe trajnimi i punonjësve të vetë shoqërisë, duke ofruar një efikasitet dhe efektivitet në diferencimin dhe menaxhimin të integruar të mbetjeve.
- Mbrojtjen e Mjedisit nga mbetjet e ndotura urbane, duke maksimizuar dobinë e tyre dhe reduktimin e CO₂ në atmosferë (dekompozimi natyror i mbetjeve), gjatë gjithë viteve të operimit të shoqërisë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror.
- Grumbullimi dhe transportimi i dherave, në vendepozitimin e caktuar brenda zones ku zhvillohet aktiviteti.
- Përdorimin e dherave për qëllime rehabilitimi dhe sistemi të argjaturës së karrierës
- Diferencimi i mbetjeve në tre fraksione kryesore të mbetjeve:
 - 1- Plastike dhe Polietilene
 - 2- Letër/Karton
 - 3- Të thata dhe të kompostueshme

Sasia e përgjithshme e mbetjeve të ngurta urbane e gjeneruar është 0,7 kg/banorë/ditë , afërsisht 8.4 kg/ditë mbetje të ngurta urbane që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve gjatë operimit të punës për shfrytëzimin e gurit gëlqeror

8. MASAT PER PERDORIMIN ME EFICENTE TE ENERGIJE.

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në shfrytëzimin e gurit gëlqeror, mbrojtjen nga erozioni, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të CO₂ dhe gazrave të tjerë të dëmshëm në atmosfere, **përdorimin e energjisë në mënyrë eficiente**, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti **“SINA 98”**, me përfaqësues ligjor Z. Shaban Sina ka hartuar “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë shfrytëzimit dhe përdorimit të teknologjisë.
- Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme.
- Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik.
- Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis.
- Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti i shfrytëzimit të gurit gëlqeror.
- Mbajtja gjithmonë fikur e automjeteve gjatë procesit të ngarkimit dhe ruajtja e distancës së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit që kryejnë shërbimin e kërkuar.
- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës, si : doreza, këpucë me veshje gome dhe metalike, syze për mbrojtjen e syve, maska kundër gazeve dhe pluhurave, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen në karrierë.
- Kapja dhe pastrimi i menjëhershëm në rast derdhesh të lubrifikantëve dhe grumbullimi i tyre në kontenier (fuçia) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjësimin e tyre përfundimtar nga kompanitë e nënkontraktuar.
- Grumbullimi, diferencimi dhe transportimi i mbetjeve të ngurta urbane çdo ditë në fund të procesit të punës në kontenierët e vendosur nga Njësia Vendore.

- Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundra ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi.
 - Testimi paraprak i gjithë teknologjisë (instalimeve) dhe rrjetit elektrik.
 - Sistemimi i sheshit të depozitimit të mineralit gëlqeror, dherave, sistemimi i shkallëve të karrierës, pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe mirëmbajtja e pemëve.
 - Ndërtimi i skarpatave dhe shesheve të shkallëve të karrierës sipas standarteve dhe kushteve teknike.
 - Shfrytëzimi i mineralit gëlqeror, brenda kordinatave dhe sipas sasis së dhënë në lejen minerare.
 - Rehabilitimi i karrierës paralelisht me shfrytëzimin e saj, me qëllim mbrojtjen nga erozioni.
 - Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit dhe impiantit të instaluar.
 - Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.
-
- Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve.
 - Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut në çdo shkallë të karrierës dhe përgjatë sheshit ku zhvillohet aktiviteti.
 - Vëzhgimi dhe kualidimi i vazhdueshëm i të gjithë teknologjisë dhe instalimeve të projektit.
 - Përdorimi eficient i energjisë elektrike si dhe sigurimi i ambientit të objektit me ndriçimin e duhur për zhvillimin e aktivitetit.
 - Diferencimi i mbetjeve sipas rrymave specifike që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve në territorin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror.
 - Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.
 - Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash.
 - Mirëmbajtja dhe kontrolli periodik i sistemit të MKZH (për mbrojtjen kundra zjarrit) dhe zëvendësimi i hidrantëve.

9.PLANI PER PARANDALIMIN DHE REABILITIMIN E MJEDISIT

Në zbatim të urdhërit të Ministrit Nr.3 datë 17/05/2006 « Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga shfrytëzimi i mineraleve metalore e jo metalor» dhe në mbështetje të Ligjit nr.10 431, date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”, shoqëria « Sina 98» shpk ka hartuar planin e rehabilitimit të karrierës së gurit gëlqeror.

a.Qëllimi i planit të rehabilitimit

Përgatitja dhe zbatimi i këtij plani rehabilitimi përgatitur në zbatim të kushteve të lejes mjedisore të veprimtarisë për të rehabilituar karrierën sipas kërkesave ligjore mjedisore duke riaftësuar sipërfaqen e shfrytëzuar të gurit gëlqeror në fshatin Priskë rrethi Tiranë.

b.Synimet e Planit të Rehabilitimit

Plani i rehabilitimit synon që në përfundim të zbatimit të mbarimit të shfrytëzimit të realizojë me sukses;

- Të ketë realizuar stabilizimin fizik (*rregjimin uhor sterilet erozionin masat esigurisë publike*) në sipërfaqen e karrierës nëpërmjet masave qëdo tëpërshkuhen më poshtë.
- Të ketë realizuar punimet biologjike duke realizuar mbjellje bimësie tëtapetit stabilizues(barishtore me rrënje xhufkore)si dhe të fidanëve.
- Të ketë mundësuar zhvillimin e proceseve natyrore të cilat dallohen qartë nëpërmjet indikatorëve abiotike dhe biologjike dhe evolojnë me stadin ezhvillimit tëriaftësimi(suksesionet biologjike).
- Të mundësojë në fazat e mëvonëshme të maturimit të procesit tërehabilitimit përdorimin e sipërfaqes së karrierës.

c.Hapja dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike

Me përfundimin e shfrytëzimit të çdo horizonti do të lihet sheshi i sigurimit megjerësi që vijon nga 5-8 m, për këtë shesh sigurimi është parashikuar në projekte që të lidhet me rrugë automobilistike e cila do të shërbejë për të kryer të gjithapunimet e nevojshme (mbushja me dhe, dhe transporte të tjera) për realizimin esheshit.

d.Hapja e kanaleve për dranzhim

Në fundin e cdo sheshi do të hapen kanale me përmasa 60 cmx50cm dhe pjerrësi 5% nga të dy krahët e sheshit për kullimin e ujrave dhe reshjeve atmosferike të cilat do të drenohen poshtë kontureve të karrierës, fenomen që shmanget erozionin në sheshin e sigurimit dhe në të gjithë karrierën.

e.Mbulimi me dhe i gjithë sheshit të sigurimit

Duke qenë se sheshi i sigurimit është shkëmbor për të krijuar kushte optimale përdrurët dhe bimësinë që do të mbillet e gjithë sipërfaqja e sheshit të sigurimit do tëmbushet me një trashësi dhe (argjile) prej 0.5 m. Të dhënat për volume dhenumerin e bimëve etj, jepen në tabelën që jepte në këtë material.

f.Masat rehabilituese

- Punime inxhinjrike
- Punime biologjike

g.Punime inxhinjrike

- Hapja dhe mirëmbajtja e rrugëve automobilistike për hyrje në sheshin esigurisë
- Hapja e kanaleve për drenazhim dhe disiplinimin e ujrave (rreshjetatmosferike)
- Mbulimi i gjithë sipërfaqes së sheshit të sigurimit me një shtresës dhe 0.5 m.

h.Punime biologjike

- Mbjellja e drurëve akacie e shegë e egër duke qenë se zona i ka të tillë.
- Mbjellja e bimësisë.
- Shërbimet profilaktike në sipërfaqet e rehabilituara.

10.MASA TE TJERA TE PLANIFIKUARA PER PARANDALIMIN E AKSIDENTEVE

a.Parandalimi i aksidenteve dhe reagimet gjatë emergjencave.

Shoqëria "SINA 98" Sh.p.k sëbashku ka nënkontraktuar specialistë të ndryshëm të fushës për hartimin e një plani, për funksionimin dhe operimin normal të punës në objektin e shfrytëzimit të gurit gëlqeror.Ky plan konsiston në menaxhimin e situatave emergjente që mund të dalin gjatëshfrytëzimit të gurit

gëlqeror. Synimi i shoqërisë "SINA 98" është mbrojtja e mjedisit, habitateve natyrore të zonës, sigurimi i jëtës së punonjësve, duke krijuar një infrastrukturë dhe kushtet e përshtatshme optimale gjatë zhvillimit të aktivitetit të sajë. Grupi i ekspertëve ka hartuar dhe improvizuar raste të ndryshme të avarive dhe emergjencave që mund të ndodhin në objektin minerar, masat që do të ndërmerren dhe grupin përgjegjës të punës për restaurimin dhe rigjenerimin e zonës që mund të jetë objekt i këtyre ndikimeve. Stimulimi i situatave të ndryshme dhe masa që do të ndërmerren, janë përshkruar në tabelën e mëposhtme: Për menaxhimin sa më të suksesshëm të aksidenteve dhe situatave emergjente, stafi i punonjësve të shoqërisë "SINA 98" që operojnë në objektin minerar për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, janë të trajnuar për përballimin e situatave të tilla. Çdo fillim muaji nën kujdesin e Drejtuesit Teknik të shoqërisë, improvizohen skema të ndryshme për përballimin e situatave të tilla, duke rritur performancën e punonjësve dhe sigurimit të punës në karrierë.

b. Plani i Përballimit të Emergjencave

Shoqëria "SINA 98" Sh.p.k. në veprimtarinë e saj, për aktivitetin "Shfrytëzim i Gurit Gëlqeror", detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria.

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të njoftojë personelin si dhe autoritetet e bashkisë ose të komunës për një rrezik imediat.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

c. Emergjencat në këtë objekt, mund të vijnë nga këto shkaqe:

Erozioni i tokës

Në rast erozioni të mundshëm, si pasojë e punimeve në karrierë, i gjithë personeli është i trajnuar për përballimin e situatave të tilla dhe për rigjenerimin sa më të shpejtë të territorit të prekur nga erozioni i mundshëm sipërfaqësor. Lartësia e shkallëve të karrierë, këndi i skarpatës, sistemi i drenazhimit të ujrave të shiut, janë projektuar në menyrë të tillë që efekti i erozionit gjatë shfrytëzimit të gurit gëlqeror të jetë minimal dhe me ndikime sa më të vogla në mjedis dhe në shëndetin e punonjësve. Duke e rikuperuar shpejt aktivitetin normal të operimit të punës në karrierë.

Rënia e zjarrit

Në rastin e rënies së zjarreve, në territorin e Shoqërisë është e afishuar skema e lajmërimit. Mbi bazën e kësaj skeme personeli që ndodhet në Shoqëri vepron duke bërë njoftimin e PMNZSH në numrat e zjarrfikëseve të afishuara në tabelat përkatëse.

Brenda aktivitetit do të funksionojë edhe lidhja telefonike dhe telefonat celulare që janë vendosur në dispozicion për lajmërimin e zjarrfikësve. Personeli present bazuar në skemën e afishuar vepron menjëherë me fikset e dorës dhe tenton të kufizojë përhapjen e mëtejshme të zjarrit.

Pajisjet dhe instalimet do të mbrohen me sistemin e shkumës antizjarr, si dhe shuarës zjarri portable dhe të lëvizshëm, të vendosur në vende të sigurta.

Evakuimi i detyruar i njerëzve në rast zjarri

Pozicioni i objekteve përbërëse të karrierës së gurit gëlqeror, sipas destinacionit që ato kanë, është i tillë që jo vetëm respekton largësitë e mbrojtjes nga zjarri, por në rast zjarri është i zgjidhur edhe evakuimi i detyruar i njerëzve dhe mjeteve prej tyre.

Ambientet e zonës të karrierës, nën administrimin e shoqërisë "SINA 98" disponojnë hapësira dhe sheshe të mjaftueshme që e furnizojnë këtë evakuim.

Rënia nën tension

Duke u nisur nga specifika që ka puna, është marrë në konsideratë edhe mbrojtja nga rënia nëntension e paisjeve dhe e personelit që punon aty.

Dhe për këtë rast janë parshikuar veprimet e menjëhershme që do të kryhen.

Nga tërmetet

Zona është e studiuar nga ana sizmike dhe konstruksionet ku janë instaluar pajisjet dhe impianti, nuk përbëjnë rrezik për tërmetet. Gjithashtu këndi i skarpatës, së shkallëve të karrierës është i tillë që të përballojë lëkundjet e lehta sizmike. Kështu në rast tërmeti do të kishim vetëm lëkundje të tokës dhe nuk do të paraqesë rrezik për personelin dhe për mjedisin përreth aktivitetit.

11. PLANI I MASAVE PËR REHABILITIMIN E MJEDISIT NE GJENDJEN FILLESTARE ME NDERPREJENE AKTIVITETIT

Bazuar në projektin e shfrytëzimit hartuar për karrieren e gurit gëlqeror rezulton sepër një periudhë me maksimale 16.4 vjecare (për prodhimin $100\ 000\text{m}^3/\text{vit}$) aktiviteti i shfrytëzimit do të fillojë në kuotën + 700 m dhe do të mbarojë në kuotën + 630m.

Gjatë këtij shfrytëzimi do të krijohen rreth $164\ 000\text{m}^2$ sipërfaqe që do të shfrytëzohet, ndërsa për një vit rreth $10\ 000\text{m}^2$ për prodhimin $100\ 000\ \text{m}^3/\text{vit}$.

Për rehabilitimin e kësaj sipërfaqeje, rehabilitim i cili do të fillojë në fund të vitintë parë të shfrytëzimit të gurit gëlqeror, subjekti me të detajuar këto lekë do titrajtojësi do të shpenzohen bazuar në masa për rehabilitimin e mjedisit si mëposhtë:

- Krijimin e sipërfaqeve për mbjellje
- Sistemimin e materialit të mbulesës të depozituar paraprakisht në kufijtë e karrierës.
- Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me shkurre të egra (dëllenja dhe shkozë) dhe barishte të ndryshme.
- Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella.

a. Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit.

Masat zbutëse të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e endotjeve gjatë punimeve në ajër, si pluhurat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore dhe në territor, në faunën dhe florën.

Por pikësynimi kryesor i studimit mbetet rehabilitimi i tokës dhe evitimi në maksimum i erozionit.

b. Masat konkrete që do të merren gjatë punimeve do të jenë:

- Mbjellje me filiza dushku, pisha e gjithë periferisë më të lartë të shpatit të territorit gjatë shfrytëzimit. Kjo masë do të shërbejë edhe për uljen e nivelit të pluhurave dhe zhurmave në vazhdim të projektit, si dhe të rrisë qëndrueshmërinë e kodrës.
- Mbjellje përpara se të fillojë shfrytëzimi i të gjitha periferive të tjera medëllenjë të kuqe dhe shkozë të bardhë, për të izoluar pjesën e fragmentizuar nga shfrytëzimi prej atyre të paprekura nga projekti duke lënë munësinë përpërhapje të mëtejshme të këtyre specieve vendase në territoret fqinje. Të dykëto masa mund të shërbejnë si bariera për pluhurin që mund të nxirret nga aktiviteti eolik gjatë shfrytëzimit.

- Uljen e tensionit të shfrytëzimit për stinën e verës duke evituar kështu me satë jetë e mundur erozionin dhe pluhurat. Nga ana tjetër për tëulur efekteterodike, gjatë periudhave të thata do të përdoret lagia e terreneve nën punëdhe sidomos, lagia e vendburimit të materialit të nxjerrë. Kjo do të evitohet dhe ndotjen gjatë transportit (materiali i thatë krijon pluhura).

c.Reabilitimi I teritorit

Masat rehabilituese do të konsistojnë në:

- Uljen e erzionit
- Restaurimin e habitateve
- Pasurimin e biodiversitetit me speciet natyrore.
- Rritjen e vlerave vizuale dhe rikrijuese të territorit që do të shfrytëzohet

Së pari shfrytëzimi me taracë me lartësi 2 m, është bërë për të lehtësuar zbatimin e planit të rehabilitimit. Këto taraca do të lejojnë si mbulimin e sipërfaqes me gjelbërime ashtu edhe evitimin e pamjeve të pakëndëshme të shpateve vertikale të terracave që mund të mbeten zbuluar në rastet e lartësive së përgjithshme të taracës rreth 4 m.

Rradha e mbjelljeve do të jetë nga lart-poshtë, duke lejuar mundësinë për vetëpërhapjen e specieve mbi bazat e aktivitetit eolik dhe forcës së rëndësës.

Gjerësia e shkallës së taracës do të jetë 5-8m, por me nënshkallë cdo 2 m. Kjo llojmbjellje lejon vetëpërhapjen e specieve, si dhe nuk dëmton në rritjen e bimëve pasinuk pengon dritëzimin.

d.Reabilitimi I tokës

Për rehabilitimin e tokës, do të shfrytëzohen mbetjet e imëta nga materiali i nxjerrë dhe do të plotësohet me 10 cm dhe (tokë) të pasur me pleh (humus dhe organik).

Nëse do të nevojitet stabilizimi i këtij dheu një pjesë e faqes së pjerrët do të bëhet me trungje të ngulura me thellësi 30 cm, mulcimi do të jetë i thatë dhe mekashtë, gjethe të bimëve të zonës dhe degë. Mulcimi do të shërbejë si për uljen e humbjeve të farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe për uljen e aktivitetit erodik për sa kohë vegjitacioni është i pa zhvilluar mirë. Mbjelljet do të kenë rënditjen me largësi fidanësh cdo 10 m, gjë që do të japë një kurorë dendësimit mirë, territorit pas shfrytëzimit, dhe lejon dritëzimin për vetëritjen dhe zhvillimin e bimëve natyrore.

e.Reabilitimi i plotë i mjedisve të territorit do të jetë si më poshtë:

Mbjellja e taracave

- Mbjellje e fushës së shfrytëzuar
- Mbjellje e taracave në tre shkallët
- Filiza 2 vjecare në periferi
- Mbjellje e filizave 2 vjecare të pemëve dhe lejimi i përtëritjes së shkurreve.

Plani i monitorimit do të konsistojnë :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike të shkallëve të shfrytëzimit si: pjerrësi, lartësi, këndi i skarpatës, pjerrësia e sheshit të punës si dhe parametrave gjeometrike të parashikuar në projekt.
- Monitorimi i sjelljes së shkëmbinjve në kufinj të jashtëm të karrierës dh marrja e masave për parandalimin e leëvizjeve të mundëshme si shkarje, shembje ose vithisje.
- Monitorim i zonës së mundëshme të shpërndarjes së pluhurit gjatë aktivitetit të shfrytëzimit.

- Monitorim i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së pluhurit dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt për parandalimin e tij.
- Monitorimi i sipërfaqeve të mbushura me material dhe tokë vegjetale për parandalimin e shplarjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen dëmtime të kësaj zone do të merren masa për riparimin e tyre.
- Monitorim i sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara, ecurisë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre. Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zëvendësimin me fidanë të rinj.
- Monitorim i çdo sipërfaqje të mbjellë do të vazhdojë për një periudhë 4 vjecare, kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë nevojë për shërbime.

Subjekti merr përsipër sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit.

Subjekti, gjithashtu do të ketë lidhje të vazhdueshme me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, pranë së cilës do të informojë periodikisht për mbarvajtjen e punës gjatë shfrytëzimit ashtu dhe për monitorimin e parametrave të mësipërm.

12. PROGRAMIN E MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT

a. Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për shfrytëzimin e gurit gëlqeror është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

b. Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të karrierës.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti minerat dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.

- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

c.Baza Ligjore e Monitorimit

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme.

d.Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2013 “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu VI “monitorim i gjendjes së mjedisit”;

- Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e lejes përkatëse mjedisore.

Monitorim i ëshdetyrë e shoqërisë investitore në nivel individual përpikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”

Investitori do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedisve gjatë fazes së punimeve ndërtimore dhe konkretisht të elementët të mëposhtëm:

- Për ajrin duhet të monitorojë Lëndën e Ngurtë Pezull (LNP) dhe zhurmat (dB).
- Për ujën, duhet të monitorojë shkarkimet e mundshme dhe rrjedhat ujore biologjike (rrëqe, proska, përrenj)
- Për tokën, duhet të monitorojë shkarjet e mundshme të dherave (erozioni)

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit dhe në rast të kundërt, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre muaj të dorëzohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto.

e.Plani i monitorimit do të konsistojë :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike tëshkallëve të shfrytëzimit si: pjerrësi, lartësi, këndi i skarpatës, pjerrësia e sheshit të punës si dhe parametrave gjeometrike të parashikuar në projekt.
- Monitorimi i sjelljes së shkëmbinjve në kufinj të jashtëm të karrierës dhëmarrja e masave për parandalimin e leëvizjeve të mundëshme si shkarje, shembje ose vithisje.
- Monitorim i zones së mundshme të shpërndarjes së pluhurit gjatë aktivitetit të shfrytëzimit.
- Monitorim i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së pluhurit dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt për parandalimin e tij.
- Monitorimi i sipërfaqeve të mbushura me material dhe tokë vegjetale për parandalimin e shplarjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen dëmtime të kësaj zone do të merren masa për riparimin e tyre.

- Monitorim i sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara, ecurisë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre. Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zëvendësimin me fidanë të rinj.
- Monitorim i çdo sipërfaqje të mbjellë do të vazhdojë për një periudhë 4 vjecare, kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë nevojë për shërbime.

Subjekti merr përsipër sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit.

Subjekti, gjithashtu do të ketë lidhje të vazhdueshme me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, pranë së cilës do të informojë periodikisht për mbarvajtjen e punës gjatë shfrytëzimit ashtu dhe për monitorimin e parametrave të mësipërm.

Eksperti Mjedisit

Gezim Agasi

Perfaqesuesi "Sina 98" shpk

Shaban Sina